PULLE TAKSE

100 LEKE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 25 Rep.

Nr. 05 Kol.

# AKTI I THEMELIMIT
# TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
# ALBANERA SHPK.

Ne Tirane, sot me 13 janar 2005 (dymije e pese), para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht personat e meposhtem :

- Z. Krenar Fezga, shtetas shqiptar, lindur ne PERMET me 11.03.1971 mbajtes i pasaportes nr. Z1243669, banues ne adresen Logo MAA. VERONA ITALI
- Z. Silvano Giuliani, shtetas italian, lindur ne VERONA me 25.02.1954 mbajtes i pasaportes nr. B663311, banues ne adresen VIA TAGLIAMENTO 14-VERONA-ITALY
- Znj. Zylkade Hoxhaj, shtetase shqiptare, lindur ne PERMET me 05.04.1941 mbajtese e pasaportes nr. 278260, banuese ne adresen Rr. Grigor HEBA, TIRANE
- Znj. Margarita Fezga, shtetase shqiptare, lindur ne PERMET me 28.05.1973, mbajtese e pasaportes nr. Z.0795584 banuese ne adresen Këlyrë, PERMET.

Te gjithe personat e paraqitur, per identitetin e te cileve u binda nga dokumentet personale qe me paraqiten, jane madhor e me pergjegjesi te plote juridike per te vepruar. Ata, me vullnetin e tyre te plote e te lire nenshkruajnr ne pranine time kete Akt Themelimi.

Neni 1

Krijimi

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ALBANERA Shpk., me poshte e quajtur "Shoqeria" krijohet nepermjet ketij akti sipas ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 2

Ortaket Themelues

Emri dhe adresa e ortakut themelues jane:

Emri i Ortakut

Z. Krenar Fezga

Z. Silvano Giuliani

Znj. Zylkade Hoxhaj

Znj. Margarita Fezga

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Kelcyre, Permet, Shqiperi.

Shoqeria, brenda hapsirave te krijuara nga ligji dhe me vendim te Asamblese se Ortakeve, te miratuar nga nje apo me shume ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit te Shoqerise, mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale dhe/ose te realizoje çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte Leke 100.000 (njeqind mije) i ndare ne 100 (njeqind) pjese me vlere nominale Leke 1.000 (njemije) secila. I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar e shlyer ne te holla nga ortaket dhe zoterohet prej tyre si vijon:

(i) Z. Krenar Fezga, 33 (tridhjete e tre) pjese qe perbejne 33% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(ii) Z. Silvano Giuliani, 27 (njezete e shtate) pjese qe perbejne 27% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(iii) Znj. Zylkade Hoxhaj, 20 (njezete) pjese qe perbejne 20% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(iv) Znj. Margarita Fezga, 20 (njezete) pjese qe perbejne 20% te te gjithe kapitalit te Shoqerise.

Neni 5

Objekti

Shoqeria ka per objekt kryerjen e çdo veprimtarie dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, ne fushen e nxjerrjes, perpunimit dhe tregtimit te gurit si material ndertimor. Shoqeria mund te kryeje çdo veprim tregtar, financiar, qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me qellim permbushjen e objektit te siperpermendur, si dhe te marre pjese ne shoqeri dhe entitete te tjera.

Neni 6

Administrimi i Shoqerise

Shoqeria do te administrohet nga tre administratore te cilet do te ushtrojne kompetencat e tyre duke vepruar ne kuadrin e nje organi kolegjial i quajtuar "Keshilli Administrativ". Keshilli Administrativ perbehet nga tre administratore nga te cilet njeri emerohet Kryetar i Keshillit Administrativ, nje Zevendes Kryetar i Keshillit Administrativ dhe tjetri anetar i thjeshte.

Nepermjet ketij Akti Themelimi, personat e meposhtem emerohen si administratoret e pare te Shoqerie:

Kryetar: Z. Krenar Fezga;

Zevendes Kryetar: Z. Silvano Giuliani;

Anetar i thjeshte : Z./Znj. Zylkade HOXHAJ

Neni 7

Pergjegjesia Personale

Prona private e ortakeve jashte kufirit te pjeseve qe ata zoteron ne kapitalin e Shoqerise, administratoriet, punemarresit, dhe/ose agjenteve te Shoqerise, jane gjithnje te perjashtuara nga detyrimet e çdo lloji qe rendojne mbi Shoqerine.

Neni 8

Norma te Organizimit

Normat per organizimin, rregullat dhe drejtimi e administrimi i aktivitetit te Shoqerise dhe çeshtjeve te saj te brendshme, jane parashikuar ne Statutin bashkengjitur, i cili mund te modifikohet ne çdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve.

DUKE QENE E QARTE PER GJITHE SA ME SIPER, ne nenshkruajme kete akt me vullnetin tone te plote e te lire, sot me date 13 janar 2005.

KRENAR FEZGA
Z. Krenar Fezga

SILVANO GIULIANI
Z. Silvano Giuliani

Znj. Zylkade Hoxhaj

Margarita Fezga
Znj. Margarita Fezga

Une Noteri lexoj me ze te larte tekstin e ketij dokumenti. Ortaket themelues, nga te cilet Z. Silvano Giuliani qe nuk kupton gjuhen shqipe u asistua nga nje perkthyes ne gjuhen italiane i njohur prej meje noterit dhe i pranuar prej Z. Giuliani, njihen me permbajtjen e tij dhe e nenshkruajne ate rregullisht ne pranine time.

Une Noteri vertetoj kete dokument sipas ligjit.

Perkthyesi

Darinka Pigari

Noteri

PULLE TAKSE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DYLBERE ELMAZAJ
NOTERE
TIRANE

2421/22

Banka Kombetare Tregtare : 14-JAN-2005

DEPOZITIM CASH NE LEK
CASH DEPOSIT IN ALL (LEK)

| | |
|---|---|
| KLIENTI: | 403046597 |
| EMRI I KLIENTIT: | "ALBANERA" SHPK |
| ADRESA E KLIENTIT: | KELCYRE |
| | PERMET |

| | |
|---|---|
| REFERENCE | : 403TCSD050140026 |
| DATE VALUTA/VALUE DATE | : 14-JAN-2005 |
| LLOGARIA E VEPRIMIT/TXN ACC | : 403046597CLPRBLALLAO |
| SHUMA E VEPRIMIT/TXN AMOUNT | : 100,000.00 ALL |
| OFS ACC | : BA1112000 |
| OFS AMOUNT | : 100,000.00 ALL |
| KURSI I KEMBIMIT/EXCH RATE | : 1 |
| NR.I CEKUT/CHEQUE NO | : |
| KODI I BANKES/CLG BANK | : |

REPUBLIKA SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr 72 Rep Dt 31.01.2005
VERTETIM
Vërtetohet se fotokopja është e njëjtë me origjinalin/ Dokumenti
u paraqit
Nr Pasap
NOTERE DYLBERE ELMAZAJ

PERMBLEDHJE E KOMISIONIT/CHARGE/TAX SUMMARY

| | | |
|---|---|---|
| SHUMA BAZE/BASE AMT | : | 100,000.00 ALL |
| TOT TAX | : | 0.00 ALL |
| KOMISIONI/TOT CHG | : | 1,500.00 ALL |
| SHUMA NETO/NET AMT | : | 101,500.00 ALL |

KRENAR FEZGA
SA DERDHUR NE LLOGARI SI GARANCI PER
KRIJIM KAPITALI FILLESTAR
************** KENAQESIA JUAJ ESHTE DETYRIMI YNE! **************

TIRANA 3
14.01.2005
11038

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ALBANERA SHPK.

Neni 1

Emertimi

Ortaket, nepemjet nenshkrimit te Aktit te Thmelimit date 13 janar 2005, nr. 25 rep., nr. 05 kol., i perpiluar perpara noterit te Dhomes se Notereve Tirane, kane themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "Albanera Shpk.", qe me poshte do te quhet shkurtimisht "Shoqeria".

Neni 2

Personaliteti Juridik i Shoqerise

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar nepermjet vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 3

Objekti i Shoqerise

Shoqeria ka per objekt kryerjen e çdo veprimtarie dhe/ose pjesemarrjen ne çdo veprim apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, ne fushen e nxjerrjes, perpunimit dhe tregtimit te gurit si material ndertimor. Shoqeria mund te kryeje çdo veprim tregtar, financiar, qe lidhet me pasuri te luajtshme e te paluajtshme, me qellim permbushjen e objektit te siperpermendur, si dhe te marre pjese ne shoqeri dhe entitete te tjera.

Neni 4

Selia e Shoqerise

4.1 Shoqeria e ka seline ne Kelcyre, Permet, Shqiperi.

4.2 Shoqeria, brenda hapsirave te krijuara nga ligji dhe me vendim te Asamblese se Ortakeve, te miratuar nga nje apo me shume ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit te Shoqerise, mund te hape edhe zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale dhe/ose te realizoje çdo lloj pjesemarrje ne shoqeri te tjera, si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqerise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe te pacaktuar kohore.

Neni 6

Kapitali i Shoqerise

6.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte Leke 100.000 (njeqind mije) i ndare ne 100 (njeqind) pjese me vlere nominale Leke 1.000 (njemije) secila. I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar e shlyer ne te holla nga ortaket dhe zoterohet prej tyre si vijon:

(i) Z. Krenar Fezga, 33 (tridhjete e tre) pjese qe perbejne 33% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(ii) Z. Silvano Giuliani, 27 (njezete e shtate) pjese qe perbejne 27% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(iii) Znj. Zylkade Hoxhaj, 20 (njezete) pjese qe perbejne 20% te te gjithe kapitalit te Shoqerise;

(iv) Znj. Margarita Fezga, 20 (njezete) pjese qe perbejne 20% te te gjithe kapitalit te Shoqerise.

6.2 Pergjegjesia e ortakeve per humbjet e Shoqerise eshte e kufizuar deri ne vleren e kontributit te paguar prej tyre ne kapitalin e Shoqerise.

6.3 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te Shoqerise.

6.4 Ne rast se njeri nga ortaket vdes, zgjidh martesen apo i jep fund bashkejeteses, pjeset e tij sipas rastit mund t'i kalojne trashegimtareve te tij apo te ndahen me bashkeshortin ose bashkejetuesin sipas dispozitave ligjore qe rregullojne rregjimin pasuror martesor apo te bashkejeteses ne rast zgjidhje te marteses apo nderprerjes se bashkejeteses, me kusht qe Asambleja e Ortakeve te Shoqerise te miratoje me ¾ e pjeseve te kapitalit te Shoqerise kalimin e pjeseve ne fjale ne favor te kerkuesit(eve). Ne kete votim nuk do te merren ne konsiderate pjeset takuese te ortakut te vdekur, qe ka zgjidhur martesen apo qe ka nderprere bashkejetesen.

6.4.1 Asambleja e Ortakeve duhet te marre vendimin per te lejuar apo refuzuar kalimin e pjeseve brenda tre muajve kalendarike nga data kur Shoqeria eshte vene ne dijeni, sipas rastit, per kerkesen e trashegimtareve te ortakut te vdekur apo per kerkesen e ish-bashkeshortit te ortakut qe ka zgjidhur martesen ose per kerkesen e ish-bashkejetuesit te ortakut qe ka nderprere bashkejetesen, nepermjet te ciles i kerkohet Shoqerise kalimi i pjeseve takuese ne favor te kerkuesit(eve).

6.4.2 Nese Asambleja e Ortakeve nuk merr vendim brenda afatit 3 mujor te caktuar ne 6.4.1 me siper, miratimi konsiderohet i dhene ne heshtje dhe pjeset transferohen pa asnje pengese tek kerkuesi(t).

6.4.3 Nese Asambleja e Ortakeve refuzon kalimin e pjeseve tek kerkuesi(t), atehere, brenda tre muajve kalendarike nga data e refuzimit, ortaket duhet te blejne ose Asambleja e Ortakeve me vendim unanim dhe nese eshte e mundur duhet te autorizoje zvogelimin e kapitalit te Shoqerine nepermjet blerjes nga Shoqeria dhe anullimit te pjeseve ne fjale.

6.4.4 Ne rast se pjeset do te blihen nga ortaket ose Asambleja miraton blerjen dhe anullimin e pjeseve ne fjale nga Shoqeria sipas 6.4.3 me siper, vlera e

pjeseve do te caktohet sipas rregullave te parashikuara ne nenin 11 te Ligjit nr. 7638/92 "Per Shoqerite Tregtare". Nese blerja nuk realizohet brenda afatit tre mujor te caktuar ne 6.4.3 me siper, atehere miratimi per kalimin e pjeseve tek kerkuesi(t) do te kosniderohet i dhene dhe pjeset mund te kalojne pa asnje pengese ne favor te tij/tyre.

6.5 Pjeset e kapitalit jane te transferueshme tek te tretet sipas dispozitave te parashikuara ne nenin 47 te Ligjit nr. 7638/92 "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 7

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise

7.1 Funksionimi dhe Kompetencat

Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te marre, por pa u kufizuar vetem ne to, vendime per:

(i) percaktimin e drejtimeve te pergjithshme te aktivitetit ekonomik te shoqerise
(ii) miratimin e struktures se Shoqerise
(iii) ndryshimin pjeserisht apo teresisht te ketij Statuti
(iv) pjesemarrjen ne shoqeri te tjera
(v) zmadhimin e zvogelimin e kapitalit te Shoqerise
(vi) transferimin teresisht apo pjeserisht te pjeseve te kapitalit te Shoqerise
(vii) emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve
(viii) emerimin e ekspertit(eve) kontabel te autorizuar te Shoqerise
(ix) miratimin e raportit financiar dhe bilancit te Shoqerise
(x) miratimin e kredive qe mund te marre Shoqeria mbi shumen EURO 150.000 (njeqind e pesedhjete mije) dhe garancite per sigurimin e tyre
(xi) shperndarjen, likujdimin e Shoqerise dhe emerimin e likuidatorit(eve).

7.2 Vendi i Mbledhjes se Asamblese

Mbledhjet e Asamblese se Ortakeve do te zhvilohen ne nje vend brenda apo jashte Republikes se Shqiperise, siç mund te percaktohet ne çdo kohe nga ortaket. Ne qofte se vendi ku do te zhvillohet mbledhja nuk eshte caktuar, ajo do te zhvillohet ne seline e Shoqerise.

7.3 Njoftimi per Mbledhjen e Asamblese

Lajmerimi i Asamblese se Ortakeve te Shoqerise behet nga Kryetari ose, ne mungese te tij, Zevendes Kryetari i Keshillit Administrativ. Ne mungese te tyre lajmerimi behet nga administratori me moshe me te vjeter. Ne mungese te te personave te siperpermendur, lajmerimi per thirrjen e Asamblese se Ortakeve behet nga eksperti kontabel i autorizuar i Shoqerise.

Nje apo me shume ortake qe zoterojne sebashku te pakten 10% te te gjithe kapitalit te Shoqerise mund te kerkojne thirrjen e Asamblese se Ortakeve.

Njoftimi i mbledhjes se Asamblese duhet te tregoje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes, dhe do t'i dergohet secilit ortak me poste te regjistruar te pakten pesembedhjete dite perpara dates se mbledhjes.

Neni 8
Administrimi Shoqerise

8.1 Keshilli Administrativ

Pasuria, aktiviteti dhe biznesi i Shoqerise do te drejtohet dhe administrohet nga tre administratore te cilet do te ushtrojne kompetencat e tyre duke vepruar ne kuadrin e nje organi kolegjial i quajtuar "Keshilli Administrativ".

Keshilli Administrativ perbehet nga tre administratore nga te cilet njeri emerohet Kryetar i Keshillit Administrativ, nje Zevendes Kryetar i Keshillit Administrativ dhe tjetri anetar i thjeshte.

8.2 Mbledhjet Keshillit Administrativ

Lajmerimi i mbledhjes se Keshillit Administrativ behet nga Kryetari ose, ne mungese te tij, Zevendes Kryetari i Keshillit Administrativ.

Njoftimi i mbledhjes se Keshillit Administrativ duhet te tregoje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes, dhe do t'i dergohet secilit ortak me poste te regjistruar te pakten dhjete dite perpara dates se mbledhjes.

Mbledhjet e Keshillit Administrativ do te zhvilohen ne nje vend brenda apo jashte Republikes se Shqiperise, siç mund te percaktohet ne çdo kohe nga Kryetari i Keshillit Administrativ. Ne qofte se vendi ku do te zhvillohet mbledhja nuk eshte caktuar, ajo do te zhvillohet ne seline e Shoqerise.

Keshilli Administrativ merr vendime me shumice votash te te pranishmeve me kusht qe ne mledhje te marrin pjese te pakten dy administratore dhe ne rast barazie votash vota e Kryetarit apo e Zvendes Kryetarit kur i pari mungon, jane percaktuese.

8.3 Kompetencat

Keshilli Administrativ ushtron te gjitha kompetencat e nevosjhme per arritjen e qellimit te Shoqerise me perjashtim te atyre qe ligji apo ky Statut ia njeh Asamblese se Ortakeve. Keshilli Administrativ emeron stafin e kontabilitetit dhe finances se Shoqerise pasi te kete marre pelqimin per kandidaturat nga Asamblesja e Ortakeve. Keshilli Administrativ raporton mbi aktivitetin e Shoqerise dhe eshte pergjegjes perpara Asamblese se Ortakeve.

Gjithashtu, Keshilli Administrativ miraton programet e zhvillimit ekonomik te Shoqerise, investimet e Shoqerise brenda kufirit te parashakiuar ne kete Statut, percaktimin e struktures se Shoqerise, miraton formen dhe rregullat e qarkullimit te dokumentacionit brenda Shoqerise, nivelin e pagave, shperblimeve dhe shpenzimeve te tjera per punemarresit e Shoqerise.

Kryetari i Keshillit Administrativ dhe, ne mungese te tij, Zevendes Kryetari kane te drejte te perfaqesojne Shoqerine karshi te treteve, duke perfshire edhe autoritetet publike dhe kane te drejten e nenshkrimit te dokumenteve ne emer dhe per llogari te Shoqerise.

Kryetari i Keshillit Administrativ ka te drejte te ushtroje çdo kompetence qe ligji i njeh administratorit, me kusht qe te mos angazhoje Shoqerine ne transaksione te çfaredo lloji qe kalojne vleren EURO 80.000 (tetedhjete mije). Ne mungese te Kryetarit keto kompetenca i ushtron Keshilli Administrativ. Per transaksionet qe kalojne vleren e siperpermndur eshte i nevojshem vendimi miratues i Keshillit Administrativ.

Zevendes Kryetari i Keshillit Administrativ ka te drejte te angazhoje Shoqerine ne transaksione me vlere qe nuk kalon shumen EURO 10.000 (dhjete mije), kurse anetari i thjeshte i Keshillit Administrativ ka te drejte te angazhoje Shoqerine ne transaksione qe nuk kalojne vleren EURO 5.000 (pesemije) ne rast se eshte autorizuar nga Keshilli Administrativ.

Kryetari i Keshillit Administrativ ka te drejte te delegojne me prokure nje pjese apo te gjitha kompetencat e tyre personave te trete te besuar prej tyre.

8.4 Emerimi dhe Kohezgjatja e Mandatit

Administratoret emerohen me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise te miratuar nga nje apo me shume ortake qe perfaqesojne me teper se gjysmen e pjeseve te kapitalit te Shoqerise. Administratoret mund te emerohen si brenda, ashtu dhe jashte bahkesise se ortakeve, pavaresisht nga shtetesia e tij. Ne vendimin e emerimit te administratorit caktohet edhe posti i tij ne Keshillin Administrativ. Administratori do te qendroje ne detyre derisa te emerohet zevendesuesi ose zevendesuesja e tij ose e saj, ose deri ne momentin e doreheqjes, shkarkimit apo vdekjes.

8.5 Shkarkimi

Asambleja e Ortakeve ka te drejte te shkarkoje çdo administrator, me vendim te marre me te njejten shumice te percaktuar ne 8.4 me siper.

8.6 Pergjegjesite

Administratoret jane individualisht pergjegjes ndaj Shoqerise ose te treteve per deme qe shkaktohen si rrjedhoje e shkeljes se dispozitave te ketij Statuti apo te ligjit nga ana e tyre.

Neni 9

Eksperti Kontabel i Autorizuar i Shoqerise

Eksperti(et) kontabel i(te) autorizuar do te emerohet(n) me vendim te Asamblese se Ortakeve ne çdo rast kur nje gje e tille kerkohet nga ligji shqiptar.

Neni 10

Viti Financiar i Shoqerise

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mbaron me 31 dhjetor 2005.

Neni 11

Shperndarja e Shoqerise

Ne çdo moment e per çdo arsye qe arrihet ne shperndarjen e shoqerise, normat per kryerjen e likujdimit dhe emerimin e likuidatorit jane ato qe parashikohen nga ligji shqiptar ne fuqi.

Neni 12

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me ligjin shqiptar.

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, do te aplikohen normat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

Neni 13

Ndryshimet

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e te zevendesohet me nje statut te ri me vendim Asamblese se Ortakeve te Shoqerise te miratuar nga nje ao me shume ortake qe zoterojne te pakten ¾ e pjeseve te kapitalit te Shoqerise.

Neni 14

Adresa e Ortakeve, Administratoreve dhe Ekspertit(eve) kontabel te Autorizuar

Adresa e ortakeve, administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar te Shoqerise, ne lidhje me raportet e tyre me Shoqerine do te konsiderohet adresa e treguar ne Aktin e Themelimit te Shoqerise ose ne aktin per transferimin e pjeseve te kapitalit ne rastin e ortakeve te rinj.

Neni 15

Gjykata Kompetente

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e konflikteve qe mund te lindin midis ortakeve, Shoqerise, administratoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar, me njeri-tjetrin, nese nuk jane zgjidhur me pajtim midis tyre.

Nenshkruhet sot me date 13 janar 2005 nga:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 26 Rep.
Nr. 06 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me 13 janar 2005 (dymije e pese), para meje Noterit te Dhomes se Notereve Tirane, u paraqiten personalisht Z. Krenar Fezga, shtetas shqiptar, lindur ne Mertinj, Permet, me 11.03.1971, mbajtes i pasaportes nr. Z1243669, Znj. Margarita Fezga, shtetase shqiptare, lindur ne Mertinj, Permet, me 28.05.1973, mbajtese e pasaportes nr. Z0795582, Z. Silvano Giuliani, shtetas italian, lindur ne Verona, Itali, me 25.02.1954, mbatjes i pasaportes nr. B663311, Znj. Zylkade Hoxhaj, shtetase shqiptare, lindur ne Permet, me 05.04.1941, mbajtese e leternjoftimit nr. UG 278260. Te gjithe personat e siperpermdnur, per identitetin e te cileve mora dijeni nga dokumetnet personale qe me paraqiten, jane madhore dhe gezojne zotesi te plote juridike per te vepruar.

Une Noteri i lexoj me ze te larte tekstin e ketij akti personave te siperpermendur dhe perkthyesi i njour nga une Noteri dhe i pranuar nga Z. Silvano Giuliani, ia perkthen njekohesisht ate nga gjuha shqipe ne ate italiane ketij te fundit. Te pranishmit, pasi e degjuan, me deklarojne se permbajtja e aktit bashkengjitur perputhet plotesisht me theniet e tyre dhe, me vullnetin e tyre te plote e lire, nenshkruajne rregullisht aktin ne fjale ne pranine time.

Une Noteri vertetoj gjithe sa me siper sipas ligjit.

PERKTHYES

Daniela Pigani (?)

NOTERE

Znj. Dylbere Elmazaj